



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni Pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 5
Prishtinë, më 27 prill 2011, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Albin Kurti, Hydajet Hyseni, Enis Kervan, Shaip Muja, Skender Hyseni, Sabri Hamiti, Donika Kadaj-Bujupi, Amir Ahmeti dhe Petar Miletqi.

Pjesëmarrës të tjerë: Lumije Murati –ZPRK, Sanije Berisha – OSBE, Rinor Beka dhe Shefki Kastrati- NDI, Ervin Ibrahim –UNDP, Albana Bylykbashi- MPJ, Driton Selmanaj- KDI, Besarta Hajdari –UP dhe mediat.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani, Manush Krasniqi dhe Elfete Alshiqi - praktikante.

Mbledhjen e kryesoi: Albin Kurti - kryetar i Komisionit.

R E N D I I D I T Ë S:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbaleve të mbajtura më 30 mars dhe 8 prill 2011,
3. Raporti i ministrit Enver Hoxhaj rreth njohjeve të reja,
4. Diskutim për inicimin e një marrëveshjeje mes Kosovës e Shqipërisë për përfaqësimin reciprok,
5. Të ndryshme.
 - a. Njoftim me kërkesën e anëtarit të komisionit z. Shaip Muja,
 - b. Takim me përfaqësuesit e organizatave mbështetëse të komisioneve parlamentare.

1. Miratimi i rendit të ditës

Komisioni e miratoi rendin e ditës me heqjen e pikës së tretë, në mungesë të ministrit Enver Hoxhaj për shkak të agjendës së tij të aranzhuar më parë.

Me kërkesë të deputetit Shaip Muja, Komisioni vendosi që tani pika 4. a) të bartet si pikë e parë e rendit të ditës.

Njoftim me kërkesën e anëtarit të Komisionit, z. Shaip Muja

Albin Kurti - Tha se me shkresën e deputetit Sh. Muja, jam i zhgënjyer pasi që këtij Komisioni parlamentar ai, ja gaboi emrin dhe e quajti Komision për marrëdhënie me jashtë. Sido që e kam shkruar ftesën zëvendëskryeministria Edita Tahiri i është përgjigjur ftesës, ka raportuar në mbledhje dhe i është përgjigjur dhjetëra pyetjeve të anëtarëve të Komisionit nga kemi mësuar gjëra shumë të vlefshme për bisedimet të cilat po zhvillohen. Në prononcimin për media, pas takimit nuk jam prononcuar në emër të Komisionit, pasi në fund të takimit nuk e kishim kuorumin e nevojshëm për të nxjerrë përfundimet e Komisionit, por jam prononcuar në cilësi të deputetit dhe të kryetarit të Komisionit. Si të komunikohet në mes të institucioneve është absurde që të më mësoni, ju z. Muja, për shkak se këto institucione i respektoj dhe asnjëherë nuk i kam keqpërdorur, asnjëherë nuk i kam shfrytëzuar, dhe në të njëjtën kohë asnjëherë nuk kam hezitur t'i ndryshoj ato për të mirë. Administrata ka insistuar që në ftesën drejtuar zëvendëskryeminstres Edita Tahiri të jetë vetëm informim lidhur me bisedimet me Serbinë, pjesa shtesë e ftesës është përgjegjësi e plotë e imja.

Sabri Hamiti - Tha se politika e jashtme e çdo vendi, por edhe e Kosovës në situatën specifike në të cilën është, duhet të jetë ose të pretendojë të jetë së paku konsensuale, që do të thotë se edhe ky Komision që ka për funksion përcjelljen e politikës së jashtme duhet të jetë konsensual. Diskutimet në mes të dy anëtarëve të Komisionit nuk duket se shkojnë nga ajo që quhet politikë e jashtme konsensuale. Në kërkesën e z. Muja atje ku thuhet se i bëhet vërejtje serioze sekretarisë, kjo vërejtje nuk qëndron, sepse shërbimi civil i Kuvendit nuk ka të drejtë të merret me formulimet politike që i bën kryetari i Komisionit. Në insistimin tuaj gjatë takimit të parë të Komisionit për ardhjen e ministrave në Komision, kam thënë se ministrat do të vijnë, por ndodh që ata nuk mund të jenë gjithmonë në dispozicion të Kuvendit, sepse mund të gjinden për disa ditë jashtë Kosovës.

Hydajet Hyseni -Tha se ne vijmë nga subjekte të ndryshme politike dhe është e natyrshme që të kemi pikëpamje të ndryshme, por më e rëndësishme se ajo që na ndan është ajo që na bashkon dhe për një klimë të tillë duhet të angazhohemi të gjithë. Për të evituar çdo mundësi dhe personalizim të çështjeve është mirë t'i përmbahemi Rregullores, Kushtetutës dhe praktikave të punës, procedurës dhe terminologjisë adekuate. Kryetari me rastin e caktimit të rendit të ditës është mirë ta konsultojë Rregulloren. Pika e rendit të ditës Raporti i ministrit rreth njohjeve të reja është e kontestueshme sepse edhe po të donte ministri të vijë për të bërë një raport nuk i mjaftojnë 2- 3 ditë, por do t'i duhej një kohë më e gjatë. Është e diskutueshme, a duhet ministri për çdo çështje të bëjë raport? Sipas Rregullores ministri ftohet për të informuar Komisionin për çështjet nga fusha e tij.

Albin Kurti – U përkujtoi se pika e rendit të ditës Raporti i ministrit Enver Hoxhaj rreth njohjeve të reja është e paraparë në planin dhe programin e punës së Komisionit për periudhën mars-dhjetor 2011, të miratuar njëzëri nga Komisioni.

Z. Muja i është drejtuar me kërkesë kryetarit të Kuvendit, dhe nuk i është drejtuar me këtë kërkesë Komisionit, megjithatë kemi bërë edhe më shumë se që thonë normat demokratike që ju kisha lutur të mos i keqpërdorni.

Donika Kadaj- Bujupi – Tha se shkresa e z. Sh. Mujës në të cilën kërkohet që të instruktohet një deputet, me gjuhën e tillë nuk është dashur fare të përcillet në Komision. Pavarësisht për cilin deputet bëhet fjalë, në vendet demokratike deputetët nuk mund të instruktohen nga askush. Raportimi i zyrtarëve të Qeverisë është obligim kushtetues dhe dhënie e llogarisë ndaj Kuvendit dhe institucioneve të vendit. Kuvendi, deputetët dhe komisionet parlamentare kanë obligim që të

kërkojnë raportim nga zyrtarët qeveritarë çdo herë kur ka nevojë të raportohet dhe të marrin të dhëna për punën dhe veprimet ose mos veprimet e tyre.

Shaip Muja – Tha se nuk e kam kontestuar ftesën për raportim të zëvendëskryeministres Edita Tahiri, përkundrazi kam kërkuar që ajo të raportoj në Komision, por e kam kontestuar paragjykimin për fjalët kompromiset e bëra atje. Qëllimet politike të kryetarit të Komisionit janë për minimin e aktiviteteve të institucioneve. Ai në njërin anë thotë unë i fuqizoj ato, e në anën tjetër thotë se sekretaria s'ka faj, sepse është qëndrimi i imi personal. Jam i interesuar të jem pozitiv në punën time.

Anëtarët tuaj, në komisione z. Kurti, nuk përjashtohet mundësia që edhe ju, në takime jashtë vendit të keni qëndrime të cilat nuk janë në dobi të fuqizimit të institucioneve të Kosovës. Në takime jashtë vendit anëtarët tuaj, edhe në media edhe në takime, pa prezencën e medieve paragjykojnë për tërë institucionet dhe individët e vendit. Znj. Bujupi, unë nuk kam kërkuar që ta instruktoj më kryetarin e Komisionit, por kam thënë që të mësohet, nëse ju mendoni se e dini Rregulloren dhe si duhet të komunikohet me letra brenda institucioneve, atëherë le të më thotë dikush se a ka qenë e drejtuar ftesa në mënyrë të rregullt. Zëvendëskryeministria Edita Tahir është treguar shumë fleksibile që ka ardhur të raportojë në Komision.

Hydajet Hyseni – Duke mos e kontestuar diskutimin e z. D. Kadaj - Bujupi, tha se raporti në mes të Komisionit dhe Ministrisë duhet të jetë ai i cili është paraparë në nenin 65 të Rregullores. Ekziston dallimi në mes të raportit dhe raportimit, ngase raporti duhet të jetë i shkruar dhe kërkon më shumë kohë për t'u përgatitur. Nuk përjashtohet mundësia e Raportit, në situata kur janë të raportueshme dhe kur të përmbushen rrethanat.

Albin Kurti – Argumentimi i ministrit për mospjesëmarrje në mbledhje është për shkak të agjendës së tij të përcaktuar më herët. Lidhur me kërkesën e z. Shaip Mujës, drejtuar Kryesisë, tha se Kryesia nuk më ka ftuar deri më tani, nëse më thërrasin, nëse do të shkoj ose jo, do të njoftoheni publikisht. Komisionin nuk do ta lëshoj, por do të përpiqem që z. Muja mos ta keqpërdor atë.

Shaip Muja - Pozicionin të cilin e keni, që të shkruani çka të doni është keqpërdorim.

Albin Kurti – Tha se qëndrimi im është se fillimi i bisedimeve me Serbinë është koncesion, por edhe gatishmëria për koncesione është tashmë kompromis. Këtë gatishmëri edhe e konfirmoi z. Edita Tahiri për çështjen e energjisë dhe të regjistrave të gjendjes civile.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbajtura më 30 mars dhe 8 prill 2011

Komisioni i miratoi procesverbalet e mbajtura më 30 mars dhe 8 prill 2011, me vërejtjen e kryetarit të Komisionit, se procesverbali nga mbledhja e mbajtur më 8 prill 2011 është shumë i shkurtër, në kuptimin që sa më e gjatë është mbledhja e Komisionit, aq më i shkurtër po del procesverbali. Në procesverbal është dashur të përfshiheshin në mënyrë më të zgjeruar pyetjet e të gjithë anëtarëve të Komisionit.

3. Diskutim për iniciimin e një marrëveshjeje mes Kosovës e Shqipërisë për përfaqësimin reciprok

Albin Kurti - Lidhur me iniciimin e një marrëveshjeje në mes Kosovës e Shqipërisë për përfaqësimin reciprok paraqiti një fjalim në Komision. Në fjalimin e tij në mes tjerash tha se Republika e Shqipërisë angazhohet për njohje të reja të shtetit të Kosovës. Ambasadorët e Kosovës e Shqipërisë bashkëpunojnë e ndihmojnë njëri - tjetrin jo formalisht, prandaj gjithsesi ka vend për

një memorandum midis MPJ- së të Kosovës dhe asaj të Shqipërisë, ku specifikohen mbrojtja dhe përfaqësimi i interesave të ndërsjella në botën diplomatike. Konventa e Vjenës për Marrëdhënie Diplomatike në nenin 6, e mundëson që dy ose më shumë shtete të akreditojnë të njëjtin person si shef të misionit në një shtet tjetër, përveç nëse shteti nikoqir e refuzon atë. Kjo praktikë është e njohur ndërkombëtarisht, përfaqësimi i një shteti përmes një shteti tjetër, në shtetin e tretë. Përfaqësimi reciprok në mes të Kosovës e Shqipërisë do të shkurtonte shpenzimet për të dy vendet. Me marrëveshje për përfaqësim reciprok, Shqipëria do të mund të na përfaqësonte në 7 vende, të cilat na kanë njohur dhe nuk kemi misione diplomatike. Po ashtu nga misionet e Shqipërisë në NATO, OSBE, BE e Këshillin e Evropës, do të mund të gëzonim përfaqësim në formë joformale ngase ende nuk e kanë njohur Kosovën. Përfaqësimin tonë brenda përfaqësimit të Shqipërisë mund ta bënim edhe në Vatikan, Argjentinë, Egjipt, Izrael, Bosnje, Greqi, Kinë e Indi. Ky përfaqësim do të ishte i nevojshëm për nevoja të ndryshme të qytetarëve si dhe në sferën e bashkëpunimit ekonomik. Konteksti politik i Kosovës imponon një ndërmarrje në drejtim të përfaqësimit reciprok e të bashkimit funksional me Shqipërinë në lëmin e politikës së jashtme dhe diplomacisë.

Përveç dy shteteve, Kosovës e Shqipërisë, ne kemi në Maqedoni, një popull shqiptar, me attribute shtetformuese dhe dy pakica në Serbi e Mal të Zi. Cilat do të jenë marrëdhëniet me ata tash? Marrëdhëniet e krijuara në kohën e Jugosllavisë ishin përderisa ndodheshim brenda një shteti, ndërsa sot jemi në katër shtete. A do t'ia lëmë çështjen e tyre vetëm Tiranës dhe një neni të Kushtetutës së Shqipërisë? Ky është një problem i madh që ka nevojë për diskutim dhe koordinim midis dy parlamenteve, dy komisioneve parlamentare për punë të jashtme dhe dy ministrive tona. Sepse, marrëdhëniet midis pjesëve të një kombi gjithsesi nuk janë të njëjta me marrëdhëniet midis partive politike në pjesë të ndryshme të kombit.

Skender Hyseni – Konventa e Vjenës rregullon në mënyrë të qartë bazën ligjore për misione të përbashkëta, jo për përfaqësim reciprok dhe kjo është një praktikë e njohur diplomatike e zbatuar nga vende të ndryshme të botës. Çështja e formalizmit të një marrëveshjeje kërkon një trajtim të gjithanshëm legal dhe politik në kontekstin e zhvillimeve rajonale dhe ndërkombëtare. Është e nevojshme që Republika e Kosovës të ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura që ndërlidhen me çështjet e njohjeve për të siguruar njohjen formale deri në anëtarësim në OKB. Në takimin e parë të ministrit të parë të MPJ- së të Kosovës me atë të Republikës së Shqipërisë është ngritur çështja e misioneve të përbashkëta, rreth së cilës ka pasur akordime të plota deri te formalizmi i saj.

Amir Ahmeti – E përshëndet idenë për të ndihmuar Ministrinë e Jashtme që të ketë bashkëpunim me Shqipërinë në përfaqësimin e jashtëm. Shtetet të cilat nuk e kanë njohur Kosovën, do të jetë vështirë që të pranojnë për të mbrojtur interesat e një shteti të cilin nuk e kanë njohur, pa marrë parasysh cilat përfaqësi do të jenë ato. Shqipëria mundet në shumë vende të na ndihmojë. Në Emiratet e Bashkuara dhe Malajzinë, Kosova ka më shumë interes që të jetë vetë prezente në këto vende. Këto vende, si vende të zhvilluara ekonomike, përmes ambasadës do të mund të sjellin investime ekonomike në Kosovë dhe të ndihmonin në procesin e lobimit dhe të njohjeve. Në disa vende MPJ- a duhet ta ketë përfaqësimin e vet, sepse do të fokusohet më shumë për njohje dhe investime në Kosovë, se sa përmes përfaqësimit të Shqipërisë ose të ndonjë shteti tjetër.

Hydajet Hyseni - Përshëndet nismën e praktikës për përfaqësim të përbashkët, praktikë e njohur edhe nga vende me kushte edhe më të mira se Kosova. Për këtë praktikë duhet të kemi bazë ligjore për të gjitha vendet me të cilat konsiderojmë se mund të kemi përfaqësim të përbashkët, si me Zvicrën, SHBA- të, që nuk është e domosdoshme të jetë një linjë e veçantë, e në këtë kuadër Shqipëria të përfaqësojë një vend të veçantë. Shqipëria në shumë vende nuk ka përfaqësim dhe ky do të ishte rast i mirë për përfaqësim të përbashkët për shembull në Koren e Jugut. Është e

nevojshme që më parë ta plotësojmë kushtin e njohjeve e më pastaj përfaqësimet. Për këtë çështje ne mund t'i rekomandojmë Qeverisë dhe Ministrisë përkatëse, të cilëve pastaj u mbetet ta implementojnë këtë çështje.

Skender Hyseni - Për bazën ligjore për formimin e misionëve të përbashkëta tha se jemi kujdesur me kohë dhe ajo ekziston në ligj, por ka pengesa të tjera të cilat duhet të tejkalohen.

Donika Kadaj Bujupi – Tha se pajtohemi të gjithë që kemi nevojë për dinamizim të fushës diplomatike, sidomos për njohje ku rezultatet po mungojnë në tre muajt e fundit, përkundër shumë adresave që tani lidhen me to. Komisioni me të gjithë anëtarët duhet të angazhohet që të japë kontributin e tij në dinamizmin e kësaj çështjeje, sepse lidhet me interesin e vendit tonë. Nuk shoh ndonjë problem që krahas angazhimit për një shtrirje më të madhe të Kosovës përmes shërbimeve diplomatike të vendeve të ndryshme, të shfrytëzojmë memorandumin me Shqipërinë dhe me vendet e tjera të rajonit lidhur me përkrahje reciproke. Nëse kemi një marrëveshje ndërshtetërore me Shqipërinë, e cila është shtet shumë para nesh, ka buxhet më të madh, ne kemi mundësi që t'i shfrytëzojmë resurset e tyre dhe logjistikën e tyre bashkërisht në disa vende aty ku ka mundësi. Këtë çështje ne do të mund ta trajtojmë edhe me rastin e takimeve të komisionëve në Shqipëri dhe nëse ka gatishmëri në mes dy palëve, pse të mos i fillojmë hapat konkret në formalizimin e këtij bashkëpunimi.

Sabri Hamiti - Çështja e shtruar është me rëndësi dhe është e paraparë në Programin e punës së Komisionit. Marrëdhëniet e jashtme janë shumë komplekse dhe nuk varen vetëm nga vullneti, por edhe nga disiplinimi, që i bije njohje dhe përgjegjësi. Kjo çështje mund të shtrohet në takimin me komisionin homolog në Shqipëri. Diplomacia parlamentare është më e lirë në bërjen publike të ideve, sepse nuk bartë përgjegjësi shtetërore. Për këto procese në Kuvend nuk vendosin komisionet, kjo çështje mund të bëhet instrument institucional me vendime të cilat i nënshkruajnë qeveritë. Ministria e Punëve të Jashtme ka hartuar Strategjinë për lobim, Programin e aktiviteteve dhe Dokumenti për politikë të jashtme, ku do të involvohet edhe ky komision, edhe Kuvendi dhe të gjitha institucionet që me Kushtetutë implikohen në Punë të Jashtme.

Shqip Muja – Përgjegjësia e Komisionit për ta ndihmuar, plotësuar, sugjeruar nëse ka nevojë edhe t'i bashkëngjithmi MPJ- së me sugjerime të ndryshme nuk do të mungojë. Kjo çështje është mjaft senzitive për ta parashtruar dhe e dobishme, por nuk garanton transparencë të plotë. Angazhimi i Shqipërisë mund të jetë i vlerësueshëm, por ka vend ndoshta edhe për kritika. Përfaqësimi në rangun teknik besoj se do të zë vend shumë më shumë, ndërsa për aspektin e njohjeve duhet parë në kontekst kompleks situatën. Për njohjet Qeveria është përkujdesur që tani të shtojë kapacitetet me personel dhe është duke e analizuar situatën me bashkëpunëtorë dhe ndërkombëtarë. Shqipëria do të ishte e dobishme në çështjet e përfaqësimit. Në këtë Komision nuk mund t'i qasemi çdo problemi me prezencën e mediave.

Albin Kurti - Në takimin e Komisionit me ministrin Hoxhaj, është thënë se janë në procedurë për përgatitjen e tre dokumenteve në Ministrinë e Punëve të Jashtme. Prandaj do të ishte e udhës t'i sugjerojmë MPJ- së, që në kuadër të këtyre dokumenteve të përfshihet edhe çështja e marrëveshjes për përfaqësim të përbashkët në mes të Kosovës dhe Shqipërisë.

4. Të ndryshme

b) Takim me përfaqësuesit e organizatave mbështetëse të komisionëve parlamentare.

Albin Kurti Tha se në këtë takim kemi ftuar përfaqësuesit e organizatave të cilat e mbështesin punën e komisioneve parlamentare të Kuvendit: OSBE- në, NDI- në dhe UNDP-në, që të na njoftojnë për projektet e tyre lidhur me Komisionin tonë gjatë këtij viti.

Rinor Beka, përfaqësues i NDI- së - Tha se në kuadër të mbështetjes së Komisionit NDI mund të ofroj mbështetje në shqyrtimin e projektligjit, monitorimin e zbatimit të ligjit, e po ashtu me kërkesë të Komisionit mund të ofrojë hulumtime dhe analiza. Në kërkesë të Komisionit NDI mund të mbështesë në angazhimin e ekspertëve në bashkëfinancim me buxhetin e Komisionit. NDI mund të ofrojë asistencë dhe ndihmë financiare në organizimin e tryezave, punëtorive dhe seminareve. Në kuadër të bashkëpunimit ndërparlamentar NDI me USAID- in ndërmjetëson në bashkëpunimin në mes të Kuvendit dhe Kongresit Amerikan, ku përfshihen një sërë aktivitete. Në këtë drejtim, në muajin maj dhe qershor, pritet të kemi dy vizitor dhe një delegacion, të cilët fillimisht do të takohen me kryetarin e Kuvendit, e më pas edhe me Komisionin. Në kuadër të bashkëpunimit ndërparlamentar dhe promovimit të idesë për anëtarësimin e Kuvendit të Kosovës në organizatat parlamentare rajonale dhe ndërkombëtare, NDI e ka një program rajonal, ku marrin pjesë zyrtarët dhe deputetët tanë.

Ervin Ibrahim, përfaqësues i UNDP-së - Tha se kjo organizatë është e fokusuar kryesisht në praktikën sociale. Përkrahja e UNDP- së për Komisionin do të mund të fokusohet për përputhjen e legjislacionit të Kosovës me agjendën e Unionit Evropian për përfshirje sociale, përmes këshillëdhënies dhe punëtorive.

Sanije Berisha, monitoruese nga OSBE, - Tha se Komisioni për Punë të Jashtme ende nuk mbulohet nga OSBE- ja me pjesën programatike. Në këtë drejtim zyrtarët nga pjesa programatike janë duke punuar dhe do ta njoftojnë Komisionin.

Hydajet Hyseni – Tha se NDI mund ta mbështesë Komisionin lidhur me ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, ndërsa me UNDP- në ka hapësirë bashkëpunimi lidhur me Letrën e bardhë, për aq sa ka lidhshmëri me punët e jashtme.

Enis Kervan – Kërkoj të informohet se a i është përcjellë Komisionit Platforma dhe Lista e ekspertëve lidhur me bisedimet me Serbinë.

Abin Kurti – I njoftoi se deri më tani nuk i është përcjellë Komisionit ndonjë material dhe, po sa t'i përcillet, do t'ju shpërndahet të gjithë anëtarëve të Komisionit.

Shaip Muja - Tha se Platforma e bisedimeve është thënë se fillimisht do t'i përcillet kryetarit dhe Kryesisë së Kuvendit, të cilët më pas atë do të ja përcjellin Komisionit, ndërsa Lista e ekspertëve gjendet në uebsite, por mund t'i përcillet edhe zyrtarisht Komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:20.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Albin Kurti